

VENDIM
Nr. 139, datë 6.9.2017

**MBI FILLIMIN E PROCEDURËS PËR SHQYRTIMIN E KËRKESËS SË SHOQËRISË
“HYDRO POWER PLANT OF KORÇA” SHPK PËR VENDOSJE TË PENGUT MBI
KUOTAT E KAPITALIT, SENDET E LUAJTSHME, SI DHE HIPOTEKËN MBI
SENDET E PALUAJTSHME TË SHOQËRISË**

Në mbështetje të neneve 16; 44, pika 1, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”; neneve 6; 7 dhe 8 të rregullores “Për procedurat e transferimit të aseteve nga të licencuarit”, të miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s, nr. 119, datë 21.7.2016, si dhe të pikave 1.3 dhe 1.6 të “Licencës për prodhimin e energjisë elektrike”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 99, datë 17.6.2016 dhe nenit 19 të rregullores “Për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016; Bordi i Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 6.9.2016, pasi shqyrtoi relacionin mbi fillimin e procedurave për shqyrtimin e kërkesës së shoqërisë “Hydro Power Plant of Korça” sh.p.k., për vendosje të pengut mbi kuotat e kapitalit, sendet e luajtshme, si dhe hipotekën mbi sendet e paluajtshme të shoqërisë,

konstatoi se:

Aplikimi i shoqërisë “Hydro Power Plant of Korça” sh.p.k., plotëson pjesërisht kërkesat e parashikuara nga ERE në rregulloren “Për procedurat e transferimit të aseteve nga të licencuarit”, si më poshtë:

- Neni 7, pika 1, germa “a” “Një ekstrakt historik i shoqërisë tregtare të të licencuarit, të lëshuar jo më vonë se 3 muaj nga data e aplikimit”, plotësuar.

- Neni 7, pika 1, germa “b” “Veprimtaria e licencuar”, plotësuar (subjekti është i licencuar nga ERE në aktivitetet e prodhimit, tregtimit dhe furnizimit të energjisë elektrike).

- Neni 7, pika 1, germa “c” “Gjendja financiare e kompanisë në kohën që paraqet kërkesën dhe efektin e pritshëm pas miratimit të transferimit të aseteve”, plotësuar.

- Neni 7, pika 1, germa “d” “Një përshkrim të kandidatit të propozuar për transferim aset, që përfshin informacion të përgjithshëm mbi veprimtarinë e shoqërisë, që përfshihet në transaksion të tri viteve të fundit dhe të vitit të fundit, kur shoqëria ka më pak se 3 vjet që është krijuar, gjendjen financiare”, plotësuar. (Banka përfituese është Intesa San Paolo Albania dhe subjekti ka depozituar dokumentacion të detajuar mbi përshkrimin e veprimtarisë së saj.)

- Neni 7, pika 1, germa “e” “Arsyet e kërkesës për kryerjen e transferimit”, plotësuar.

- Neni 7, pika 1, germa “P” “Efektet e pritshme të transferimit në aktivitetin e të licencuarit”, plotësuar.

- Neni 7, pika 1, germa “g” “Efekti në furnizimin e rregullt e të qëndrueshëm të klientëve të të licencuarit dhe në tarifat e aktivitetit të licencuar”, plotësuar.

- Neni 7, pika 1, germa “h” “Marrëveshje paraprake e nënshkruar midis palëve në një nga format e parashikuara nga ligji, për transferimin e aseteve. Marrëveshja duhet të përmbajë një listë të detajuar të aseteve që kërkohet të transferohen”, plotësuar.

- Neni 7, pika 1, germa “i” “Deklaratë me shkrim e personit tek i cili është propozuar të bëhet transferimi, ku të shprehë gatishmërinë e tij për të garantuar vetë apo me palë të tjera veprimtarinë e licencuar pas kryerjes së transferimit”, pa plotësuar

- Neni 7, pika 1, germa “j”. Nëse ka pasur, listën e transferimeve të kryera me herët nga i njëjti subjekt, subjekti “Hydro Power Plant of Korça” sh.p.k. ka një transferim të mëhershëm asetesh për të cilin ERE është shprehur me vendimin nr. 171, datë 24.12.2012 “Për miratimin e kërkesës së shoqërisë “Hydro Power Plant of Korça” sh.p.k. për lënie peng si kolateral të aseteve të saj pranë BERZH-it”.

- Neni 7, pika 3 “Subjektet koncencionare të licencuara, të cilët aplikojnë për miratimin e transferimit të aseteve në ERE, duhet të shprehin në formë të shkruar në marrëveshjen e transferimit të aseteve, detyrimet

me të cilat ngarkohen për shkak të marrëveshjes së koncensionit e pjesët që transferojnë te përfituesi”. Nuk rezulton që subjekti të ketë depozituar në ERE miratimin e Ministrisë së Energjisë dhe Industrisë për këtë vendosje të pengut mbi kuotat e kapitalit, sendet e luajtshme, si dhe hipotekën mbi sendet e paluajtshme të shoqërisë.

Objekt i Rregullores për procedurat e transferimit të aseteve nga të licencuarit”, të miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s, nr. 119, datë 21.7.2016 janë shitja, dhënia me qira, transferimi, hipotekim, barre ose çfarëdolloj disponimi tjetër të pajisjeve ose aseteve fikse të të licencuarit, të përdorura për kryerjen e veprimtarisë së prodhim, transmetim, shpërndarjes së energjisë elektrike.

Kuotat e kapitalit dhe sendet e paluajtshme që nuk i shërbejnë aktivitetit të licencuar nuk janë objekt shqyrtimi nga ERE.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE

VENDOSI:

1. Të fillojë procedurën për shqyrtimin e kërkesës së shoqërisë “Hydro Power Plant of Korça”sh.p.k. për vendosje të pengut mbi sendet e paluajtshme të shoqërisë.

2. Të mos fillojë procedurën për shqyrtimin e kërkesës së shoqërisë “Hydro Power Plant of Korça” për vendosje të pengut mbi kuotat e kapitalit dhe sendet e luajtshme.

3. Drejtoria e Licencimit dhe e Monitorimit të Tregut, të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim mund të ankimohet në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga botimi në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Petrit Ahmeti